



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.533/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti, kryesues, Bujar Muzaqi dhe Violeta Husaj Rugova, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.02.2025, merr këtë,

#### VE N D I M

Refuzohen të pa bazuara ankesat A.nr.533/2025, Anr.535/2025, Anr.536/2025, Anr.548/2025, Anr.554/2025, Anr.555/2025, Anr.558/2025, Anr.561/2025, Anr.564/2025 të datës 10.02.2025, të parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

#### A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar ankesat: A.nr.533/2025, Anr.535/2025, Anr.536/2025, Anr.548/2025, Anr.554/2025, Anr.555/2025, Anr.558/2025, Anr.561/2025, dhe Anr.564/2025 të datës 10.02.2025, të parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Në ankesën A.nr 533/2025, pretendohet se më datë Më 9 shkurt 2025, rreth orës 14, znj. Jona Hoxhaj, përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, ka postuar në rrjetin Instagram një storie-fotografi ku shfaqet duke votuar, dhe e ka shoqëruar foton me mbishkrimin: "Dil voto Për një Kosovë më të mirë #mamire ". Hashtagu#mamirë është slogani që PDK ka përdorur gjatë fushatës. Parashtruesi i ankesës thekson se znj. Hoxhaj është shefe e kabinetit të kryetarit të komunës së Prizrenit, z. Shaqir Totaj, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës. Postimi është bërë ditën e zgjedhjeve dhe gjatë kohës sa qendrat e votimit kanë qenë të hapura. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: Pamje e ekranit me storien e përfaqësueses së subjektit politik.

Në ankesën Anr.535/2025 pretendohet se Më 09 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! gjatë monitorimit të ditës së zgjedhjeve, ka identifikuar fotografi të publikuar në facebook nga Vedat Kurshumliu, mbështetësi i subjektit politik PDK, duke shkruar "për 4 vjet #MaMirë, Bedri Hamza Kryeministër, voto 131 PDK", gjatë kohës kur është e ndaluar çdo formë e fushatës, konkretisht në ditën e zgjedhjeve pas hapjes së Vendvotimit. Kjo fotografi është e shoqëruar me numrin e subjektit politik PDK (131) dhe është bërë me qëllim të promovimit të subjektit politik dhe ndikimin tek votuesit. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: Linku i fotografisë si dhe fotografia e publikuar në profilin e facebook dhe dëshmi për përkatësinë e mbështetësit: <https://www.facebook.com/vedat.kurshumliu.9>.

Në ankesën Anr.536 pretendohet se në ditën e zgjedhjeve, përkatësisht më 9 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! kanë identifikuar se kandidati nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës PDK, z. Ramë Vataj, ka thyer heshtjen zgjedhore me postimin e tij të sponsorizuar në llogarinë e tij në rrjetin social Facebook Postimi i tillë ka qenë aktiv i sponsorizuar më 9 shkurt, pas orës 07.00 e tut-je, ndonëse heshtja zgjedhore kishte filluar me hapjen e qendrave të votimit për votim, përkatësisht në ora 07.00. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur CD me materiale që dëshmojnë publikimin në kundërshtim me LZP dhe Rregulloren Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Në ankesën Anr.548/2025 pretendohet se në ditën e zgjedhjeve, përkatësisht më 9 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! kanë identifikuar se kandidati nga radhët e subjektit, Partia Demokratike e Kosovës-PDK, Fadil Millaku, ka thyer heshtjen zgjedhore me postimet e tij të sponsorizuara në faqen e tij zyrtare. Postimet e tilla të sponsorizuara kanë qenë qenë aktive të sponsorizuara më 9 shkurt 2025, pas orës 07.00 e tutje, ndonëse heshtja zgjedhore kishte filluar me hapjen e qendrave të votimit për votim, përkatësisht në ora 07.00. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur CD me materiale dhe foto që dëshmojnë publikimin në kundërshtim me LZP dhe Rregulloren Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Në ankesën Anr.554/2025 pretendohet se më 09 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Shtime, në qendrën e votimit nr.2201, në Gjimnazin "Naim Frashëri" në Shtime, gjatë monitorimit të ditës së zgjedhjeve, është hasur në një fletëvotim (mostër), me të cilën është mbështjellë ushqimi që u është dërguar anëtarëve të KVV-ve në atë qendër të votimit, ku është hijezuar/shënuar subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës si dhe janë shënuar kandidatët nga ky subjekt politik me numër rendor 1, 2 dhe 73. Pashtuesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të gjendjes faktike në VV nr.2201.

Në ankesën Anr.555/2025 pretendohet se më 09 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Skenderaj, gjatë monitorimit të ditës së zgjedhjeve, ka vërejtur posterë të Partisë Demokratike të Kosovës, numrin e subjektit në këto zgjedhje "139" dhe fotot e ish Liderëve të kësaj partie z. Kadri Veseli dhe Z. Hashim Thaçi, të vendosur gjatë kohës kur është e ndaluar çdo formë e fushatës, konkretisht ditën e zgjedhjeve pas hapjes së Vend Votimeve ashtu siç ligji e përcakton. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi e gjendjes faktike.

Në ankesën Anr.558/2025 pretendohet se ditën e zgjedhjeve dhe gjatë kohës sa qendrat e votimit kanë qenë të hapura, më 9 shkurt 2025, kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike të Kosovës, z. Bedri Hamza, ka folur për media, duke thënë ndër të tjera

"Kosova m'u kanë ma mirë". Kjo deklaratë përkon me sloganin e fushatës së PDK-së. Kështu z. Hamza ka bërë fushatë gjatë kohës sa qendrat e votimit kanë qenë të hapura, çka ndalohet me nenin 37.1.2 të LZP-së. Z. Hamza gjithashtu ka shfrytëzuar mediat me qëllim të ndikimit tek votuesi, në kundërshtim me nenin 8.1.5 të Rregullores (KQZ) nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: regjistrimin e deklaratës së transmetuar në televizion, në disk CD.

Në ankesën Anr.561/2025 pretendohet se më 09 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Skenderaj, gjatë monitorimit të ditës së zgjedhjeve, ka vërejtur posterë të kandidatit z. Patriot Krasniqi me numër 88 në listë, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, të vendosur nga mbështetës në rr. "Faik Konica", gjatë kohës kur është e ndaluar çdo formë e fushatës, konkretisht ditën e zgjedhjeve pas hapjes së vendvotimeve në ora 07:00 me datë 09.02.2025. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të gjendjes faktike.

Në ankesën Anr.564/2025 pretendohet se më 09 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Skenderaj, gjatë monitorimit të ditës së zgjedhjeve, ka vërejtur poster të kandidates z. Ganimete Musliu, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, të vendosur gjatë kohës kur është e ndaluar çdo formë e fushatës, konkretisht ditën e zgjedhjeve pas hapjes së vendvotimit (2101/03) në shkollën teknike. Duke marrë parasysh se në çdo qendër votimi janë prezent komisionerë të të gjitha partive, nga komisionerët e partisë tonë është marrë lajmi se këto reklama janë vendosur dhe për të njëjtat PDK nuk ka marrë masa që të i largoj. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të gjendjes faktike në VV 2101/03.

PZAP iu drejtua për përgjigje subjektit politik PDK lidhur me ankesat e parashtruara ndaj të njëjtit subjekt.

Në përgjigjen për ankesën Anr.533/2025 theksohet se ankuesi me qëllim që PZAP ta vendos në lajthitje ka ofruar fakte të rreme gjoja se postimi i znj. Jona Hoxhaj është publikuar pas hapjes së vendvotimeve, ndonëse fotografia e tillë është publikuar një ditë para hapjes së vendvotimeve, respektivisht më datë 08 shkurt 2025 dhe se foto është realizuar në Zgjedhjet e Përgjithshme të vitit 2021, ndërsa ankuesi ka dështuar që të provoj kohën e saktë të publikimit të postimit të znj. Jona Hoxha dhe këtë provën nuk e ka bashkëngjitur për arsyen e vetme se nga ajo provë do të vërtetohej fakti se postimi nga znj. Jona Hoxhaj është publikuar një ditë para hapjes së vendvotimeve dhe jo pas hapjes së vendvotimeve siç pretendohet nga ana e ankuesit. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka theksuar po ashtu se vlerësojmë se ankuesi, si palë e cila bartë barrën e të provuarit, ka dështuar që të vërtetoj faktin se kur është postuar postimi në fjalë, ndërsa për faktin se storjet në rrjetin social Instagram zgjasin 24 orë, ndërsa ankesën e ka pranuar 3 ditë pas shkeljes së pretenduar, e ka të pamundur që të argumentoj datën e publikimit të këtij postimi, megjithatë një detyrim i tillë i përket ekskluzivisht ankuesit dhe jo subjektit ndaj të cilit paraqitet ankesë, ashtu që ankesa e ankuesit përbën ankesë të pasafatshme cilje si e tillë të hedhet si e palejuar.

Në përgjigjen Anr.535/2025 theksohet se PDK me rastin e shikimit të profilit të z. Vedat Kurshumliu nuk ka arritur të identifikoj një postim të publikuar nga i njëjti pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00 andaj si i tillë, andaj e keni të pamundur të deklarohemi në lidhje me këtë pretendim, për faktin se nuk jemi në njohuri nëse ankesa e tillë është parashtruar brenda afatit të përcaktuar ligjor, pasi që ankuesi ka dështuar që të provoj me prova të pakontestueshme që ky publikim të jetë bërë pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00 të datës 09.02.2025.

Në përgjigjen për ankesën Anr.536/2025 theksohet se Ankuesi me qëllim që PZAP ta vendos në lajthitje ka ofruar fakte të rreme gjoja se postimi i z. Ramë Vataj është publikuar pas hapjes së vendvotimeve, ndonëse fotografia e tillë është publikuar shumë ditë para hapjes së vendvotimeve dhe se e njëjta ka qenë e sponsorizuar për publikim nga rrjeti social Facebook, deri më datën 8 shkurt 2025, e cila argumentohet nga prova e bashkëngjitur në këtë përgjigje, ku shihet se në kolonën ENDS përcakton se skadimi i sponsorizimit është me datë 8 shkurt 2025, ndërsa fakti se një fotografi e tillë ka qenë aktive në rrjetin e tij social Facebook, në asnjë mënyrë nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore, respektivisht të heshtjes zgjedhore, për faktin se e njëjta nuk është postuar, respektivisht publikuar pas hapjes së vendvotimeve andaj edhe si e tillë në asnjë mënyrë nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore të pretenduara me ankesë. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë si provë ka bashkëngjitur: Të dhënat e sponsorizimit të postimit të z. Ramë Vataj në rrjetin social Facebook, skadencia e të cilës është për datën 8 shkurt 2025.

Në përgjigjen për ankesën Anr.548/2025 theksohet se Ankuesi me qëllim që P ZAP ta vendos në Lajthitje ka ofruar fakte të rreme gjoja se postimi i z. Fadil Millaku është publikuar pas hapjes së vendvotimeve, ndonëse fotografia e tillë është publikuar shumë ditë para hapjes së vendvotimeve, ndërsa fakti se një fotografi e tillë ka qenë aktive në rrjetin e tij social Facebook, në asnjë mënyrë nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore, respektivisht të heshtjes zgjedhore, për faktin se e njëjta nuk është postuar, respektivisht publikuar pas hapjes së vendvotimeve, andaj edhe si e tillë në asnjë mënyrë nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore të pretenduara me ankesë.

Në përgjigjen për ankesën Anr.554/2025 theksohet se Ankuesi ka dështuar që të ofroj prova të besueshme dhe të pakontestueshme për të mbështetur pretendimet e ngritura me ankesë, pasi që siç mund të vërej paneli, nga fotografia e bashkëngjitur nuk mund të vërehet lokacioni në të cilën është realizuar kjo fotografi, e njëjta mund të jetë realizuar në selinë përkatëse të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dhe përveç kësaj, ankuesi ka lëshuar që të argumentoj përgjegjësinë subjektive të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, respektivisht nuk ka arritur që të dëshmoj që ky fletëvotim (mostër) të jetë sjellë nga mbështetës/aktivistë apo simpatizantë i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Në përgjigjen për ankesën Anr.555/2025 Baneri/posteri i theksuar nga ana e ankuesit në këtë ankesë është vendosur gjatë fushatës zgjedhore dhe nuk është vendosur pas hapjes së vendvotimeve dhe si i tillë nuk bie në kundërshtim me nenin 37, par. 2 të LZP-së, ndërsa siç vërehet në këtë ankesë, as vetë ankuesi nuk ka pretenduar që ky baner të jetë vendosur pas hapjes së vendvotimeve, mirëpo vetëm ka pretenduar se ka vërejtur posterë të Partisë Demokratike e Kosovës andaj në rrethanat e rastit konkret, konsiderojmë se për faktin se simpatizantët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje kanë vërejtur banerin e vendosur të subjektit politik PDK, nuk përbën shkelje të heshtjes zgjedhore, pasi që i njëjti ka qenë i vendosur gjatë fushatës zgjedhore, në përputhje të plotë me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Në përgjigjen për ankesën 558/2025 theksohet se PDK konsideron se z. Hamza me deklarin e tij se "*Kosova m 'u kanë ma mirë* ", në asnjë mënyrë nuk shpërfaqë qëllim të ndikimit tek votuesit, pasi që slogani i PDK për gjatë fushatës zgjedhore ka qenë #mami, ndërsa deklarimi se "*Kosova m 'u kanë ma mire* ", në asnjë mënyrë nuk përbën qëllim të ndikimit tek votuesit, mirëpo shfaq një vizion personal të z. Hamza, i cili thekson se nga këto zgjedhje pret që Kosova të jetë më mirë dhe se këtë nuk e ka bërë me qëllim të ndikimit tek votuesit.

Në ankesën Anr.561/2025 theksohet se Baneri/posteri i theksuar nga ana e ankuesit në këtë ankesë është vendosur gjatë fushatës zgjedhore dhe nuk është vendosur pas hapjes së vendotimeve dhe si i tillë nuk bie në kundërshtim me nenin 37, par. 2 të LZP-së, ndërsa siç vërehet në këtë ankesë, as vetë ankuesi nuk ka pretenduar që ky baner të jetë vendosur pas hapjes së vendotimeve, mirëpo vetëm ka pretenduar se ka vërejtur posterë të kandidati z. Patriot Krasniqi andaj në rrethanat e rastit konkret, konsiderojmë se për faktin se simpatizantët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje kanë vërejtur banerin e vendosur të subjektit politik PDK, nuk përbën shkelje të heshtjes zgjedhore, pasi që i njëjti ka qenë i vendosur gjatë fushatës zgjedhore, në përputhje të plotë me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Në përgjigjen për ankesën Anr.564/2025 theksohet se poster i theksuar nga ana e ankuesit në këtë ankesë është vendosur gjatë fushatës zgjedhore dhe nuk është vendosur pas hapjes së vendotimeve dhe si i tillë nuk bie në kundërshtim me nenin 37, par. 2 të LZP-së, ndërsa siç vërehet në këtë ankesë, as vetë ankuesi nuk ka pretenduar që ky baner/poster të jetë vendosur pas hapjes së vendotimeve, mirëpo vetëm ka pretenduar se ka vërejtur posterë të kandidates z. Ganimete Musliu, andaj në rrethanat e rastit konkret, konsiderojmë se për faktin se simpatizantët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje kanë vërejtur posterë e vendosur të subjektit politik PDK, nuk përbën shkelje të heshtjes zgjedhore, pasi që i njëjti ka qenë i vendosur gjatë fushatës zgjedhore, në përputhje të plotë me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës. Për më tepër, nga fotografia e bashkëngjitur në këtë ankesë, është e pamundur që të identifikohet një poster i vendosur në murin përkatës dhe rrjedhimisht ankuesi gjithashtu ka dështuar që të ofroj prova të besueshme që një fotografi të jetë realizuar më datë 9 shkurt 2025 dhe gjithashtu edhe lokacionin e saktë të posterit i cili është objekt i kësaj ankese.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr.05/1-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.533/2025, Anr.535/2025, Anr.536/2025, Anr.548/2025, Anr.554/2025, Anr.555/2025, Anr.558/2025, Anr.561/2025 dhe Anr.564/2025 të datës 10.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.533/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekte politike LVV kundër subjektit politik LDK për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesave dhe përgjigjeve në ankesa, vëren se ankesat janë të pa bazuara.

Paneli pas vlerësimit të ankesave dhe provave të bashkëngjitura në ankesat e cituara më lartë si dhe përgjigjes në ankesa dhe provat e bashkëngjitura erdhi në përfundim se pretendimet e ankuesit në ankesat e tyre, se mbështetësit dhe kandidatët e subjektit politik PDK kane thyer rregullat zgjedhore ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës janë të pa bazuara.

Paneli duke analizuar ankesën Anr.533/2025, vërtetoi se, i njëjti postim është bërë në storje 24 orësh të rrjetit social Instagram andaj nuk mund të vërtetohet koha e saktë e publikimit.

Paneli duke analizuar ankesën Anr.535/2025, vërtetoi se nuk mund të vërtetohet qartë se ky postim është bërë pas hapjes se vendvotimeve.

Paneli duke vlerësuar ankesën Anr.536/2025 dhe bazuar në provën e ofruar në përgjigjen në ankesë vërtetoi se i njëjti postim është bërë me datën 08.02.2025 dhe ka qenë i sponsorizuar deri më datën 08/02/2025.

Paneli duke vlerësuar ankesën Anr.548/2025, vëren se nga prova e ofruar nga ankuesi nuk mund të identifikohet saktë në cilën kohë është publikuar i njëjti postim.

Paneli duke vlerësuar ankesën Anr.554/2025, vëren se nuk mund të identifikohet saktë vendi i shkeljes se pretenduar që të mund t'ia falim besimin pretendimeve të ankuesit.

Paneli duke vlerësuar ankesën Anr.555/2025, vëren se nuk mund të vërtetohet se i njëjti poster është vendosur ditën e hapjes se vendvotimit.

Paneli duke vlerësuar ankesën Anr.558/2025, vëren se i njëjti është deklaruar për media por nuk e ka promovuar subjektin e tij politik me thëniet e tij në media.

Paneli duke vlerësuar ankesën Anr.561/2025, vëren se i njëjti veprim nuk mund të vërtetohet saktë se është bërë gjatë ditës së zgjedhjeve, gjithashtu nuk mund të identifikohet saktë lokacioni i përmendur në ankesë.

Paneli duke vlerësuar ankesën Anr.564/2025, vëren se nuk mund të dihet saktë vendi ku është vendosur posteri, kurse nga prova e ofruar është i pamundshëm të shihet fotoja, dhe nuk mund të vërtetohet se e njëjta është vendosur gjatë ditës së votimit.

Në këtë kuptim, Paneli, pretendimet ankimore i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në prova konkrete, pasi që nga provat e bashkangjitura ankesave nuk vërtetohet se nga subjekti politik PDK është gjetur në shkelje të nenit 37 paragrafi 1.2 i LZP, i cili përcakton se *“Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohej secili prej veprimeve si më poshtë: 1.2 Bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*.

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, i cili përcakton se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi, parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetojnë pretendimet e theksuara si më lartë.

Prandaj, nga sa u tha më lartë ankesat vlerësohen si të pa bazuara duke u bazuar në nenin 118, paragrafi 1, të LZP-së, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.533/2025 datë 09.01.2025



Këshillë Juridike; Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.